



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raporti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit

SISTEMI I TATIMIT NË PRONË



Prishtinë, gusht 2025

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetuta dhe Ligji^[1] i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur, i cili e ndihmon Auditorin Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj. Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të kontribuojmë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike. Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000¹ dhe Udhëzuesin për Auditimin e Sistemeve të Informacionit (GUID 5100²).

Auditimet e teknologjisë së informacionit të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë një ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe kontrolleve përkatëse për të fituar siguri mbi parimet e ligjshmërisë, efikasitetit³, ekonomisë⁴, dhe efektivitetit⁵ të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe kontrolleve përkatëse.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me këtë raport të auditimit “Sistemi i Tatimit në Pronë - SITP” në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme Myrvete Gashi Morina, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Samir Zymberi, Drejtor i departamentit të auditimit;
Poliksena Berisha, Udhëheqëse e ekipit;
Gazmend Lushtaku, Anëtar i ekipit; dhe
Atdhe Gashi, Anëtar i ekipit.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT – Adresa:Rr. Ahmet Krasniqi nr. 210, Lagjja Arbëria, Prishtinë 10000, Kosovë
Tel: +383(0) 38 60 60 04/1011
<http://zka-rks.org>

[1] Ligji 05_L_055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

¹SNISA 3000 – Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike

²GUID 5100 – Udhëzuesi për auditimin e sistemeve të informacionit lëshuar nga INTOSAI

³ Efikasiteti – Parimi i efikasitetit nënkupton të marrësh maksimumin nga resurset në dispozicion. ka të bëjë me lidhshmërinë ndërmjet resurseve të angazhuara dhe rezultateve të dhëna në kuptim të sasisë, cilësisë dhe kohës

⁴ Ekonomia –Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së resurseve. Resurset e përdorura duhet të jenë në dispozicion me kohë, në sasi dhe cilësi të duhur dhe me çmimin më të mirë

⁵ Efektiviteti – Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritura.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	5
1 Hyrje.....	7
2 Objektivi dhe fushat e auditimit	9
3 Gjetjet e auditimit	10
3.1 Blerja dhe Zhvillimi	11
3.2 Kontrollat e aplikacionit	13
4 Konkluzionet	20
5 Rekomandimet	22
Shtojca I. Dizajni i auditimit.....	24
Fushat me rrezik dhe treguesit e problemit të auditimit.....	24
Përshkrimi i sistemit.....	25
Fushëveprimi dhe pyetjet e auditimit.....	29
Kriteret e auditimit	29
Metodologjia e auditimit.....	31
Dokumentet relevante.....	32
Shtojca II: Letër Konfirmimi.....	33

Lista e shkurtesave

ARC	Agjencia e Regjistrimit Civil
CAAT	Teknikat e auditimit me ndihmën e kompjuterit (Computer assisted audit techniques)
ISO/IEC	Organizata Ndërkombëtare për Standardizim/Komisioni Ndërkombëtar Elektroteknik (International Organization for Standardization/International Electrotechnical Commission)
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
SITP	Sistemi Informacionit të Tatimit në Pronë
TI	Teknologjia e Informacionit
UNIREF	Numër Unik Reference (Unique Reference Number)
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

Përmbledhje e përgjithshme

Tatimi në pronë në Kosovë është burim kryesor i të hyrave vetanake për komunat dhe një instrument i rëndësishëm për financimin e shërbimeve publike lokale. Ky tatim, aplikohet mbi të gjitha pronat e paluajtshme pavarësisht destinimit të tyre. Administrimi i tij realizohet përmes Sistemit të Tatimit në Pronë (SITP), i cili ofron shërbime elektronike për regjistrim, faturim dhe pagesë, duke e bërë procesin më të qasshëm e transparent. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka rol udhëheqës dhe mbikëqyrës në nivel qendror, ndërsa komunat administrojnë procesin në territorin e tyre, duke përfshirë regjistrimin e pronave, lëshimin e faturave dhe mbledhjen e pagesave. Të hyrat e mbledhura përdoren për zhvillimin e projekteve dhe shërbimeve që përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve.

Tatimit në pronë ka rëndësi të veçantë për qytetarët, bizneset si dhe komunat dhe nivelin qendrorë. Për shkak të rëndësisë që ka Sistemi i Tatimit në Pronë, Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e Teknologjisë së Informacionit për të vlerësuar nëse menaxhimi i sistemit të tatimit në pronë nga palët përgjegjëse është në funksion të sigurimit të të dhënave cilësore, të sakta, të plota dhe të besueshme. Zyra Kombëtare e Auditimit ka realizuar edhe në të kaluarën, auditime që ndërlidhen me këtë sistem dhe vlerësime të të dhënave nga ky sistem gjatë auditimeve të pasqyrave financiare dhe pajtueshmërisë.

Sistemi i Tatimit në Pronë (SITP) luan një rol kyç në administrimin e tatimit në pronë dhe ofron një platformë të integruar të të dhënave të tatimit në pronë që përdoret në nivelin lokal të Republikës së Kosovës për të ofruar këtë shërbim në formë elektronike. Zhvillimi i këtij sistemi ka transformuar administrimin e tatimit në pronë duke e bërë më të menaxhueshëm si platformë të centralizuar me një bazë të të dhënave të vetme për të gjitha komunat.

Tatimi në pronë, i financuar nga SIDA suedeze që nga viti 2008, fillimisht ishte i fokusuar vetëm në objekte, ndërsa më pas u zgjerua edhe në tatimin mbi tokën. Në vitin 2018 u bë unifikimi i pronave për tatimpaguesit dhe për herë të parë u lëshua një faturë unike që sistemi duhej ta shpërndante automatikisht nëpër prona. Por ky funksionalitet nuk ishte testuar mirë dhe mangësitë vazhdojnë ende. Dokumentimi mbi sistemin dhe aplikacionet ndihmëse mungonte, ekipi zhvillues i sistemit i kontraktuar nga SIDA u largua pa proces dorëzim-pranimi, dorëzim standard të kodit burimor si dhe plani i ri zhvillimor i sistemit nuk u realizua nga SIDA. Kjo vështirësoi mirëmbajtjen e sistemit.

Duke marrë parasysh këto kufizime funksionale dhe teknike MFPT ka vendosur të zhvillojë një sistem të ri, më të adaptueshëm ndaj ndryshimeve dhe të qëndrueshëm. Duke ruajtur funksionet dhe bazën e të dhënave të SITP si bazë për këtë sistem.

Prandaj edhe ZKA ka fokusuar auditimin në kontrollet e zhvillimit dhe kontrollet e aplikacionit që identifikojnë mangësitë e deritanishme me qëllim evitimin e rrezikut për zhvillimet e reja.

Ky auditim ka evidentuar mangësi të rëndësishme që ndikojnë në funksionimin e tij të përgjithshëm dhe evitimin e tyre në sistemin e ri.

Mungesa e procedurave të standardizuara për testim dhe aprovime të ndryshimeve, menaxhimi joefektiv i kërkesave të zhvillimeve, si dhe kontrollet e dobëta të aplikacionit kanë ndikuar negativisht në saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të tatimit në prone në këtë sistem. Këto dobësi paraqesin rrezik për funksionim të saktë të sistemit dhe mos përmblidhjen e kërkesave ligjore lidhur me shpërndarjen e drejtë të faturimeve/pagesave, përdorim joefikas të burimeve dhe cenim të integritetit e sigurisë së sistemit.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve nuk arrin të siguroj që zhvillimet që realizohen në sistemin e tatimit në pronë arrijnë saktësisht qëllimin e tyre, në mungesë të procedurave që sigurojnë kontrole të brendshme funksionale lidhur me testimin e zhvillimit të ndryshimeve në sistem, aprovimit dhe refuzimit të zhvillimit të ndryshimeve dhe menaxhimit e trajtimit të kërkesave për zhvillim. Duke shkaktuar, menaxhim jo efikas të burimeve, krijohen mbivendosje dhe shmangie të përgjegjësive, ndërsa zhvilluesit i bie të vlerësojnë punën e tyre, duke ulur performancën, dobësuar monitorimin dhe rrezikuar cilësinë e zgjidhjeve, si dhe përmbushjen e objektivave të tyre funksionale.

Mungesa e kontroleve hyrëse në aplikacion për Sistemin e Tatimit në Pronë ka krijuar rrezeqe serioze për saktësinë e të dhënave dhe integritetin e shërbimeve. Janë evidentuar mangësi në ndërlidhjen e sistemit me regjistrin e të dhënave të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, si dhe ndërlidhjes me Sistemin e Anketimit, po ashtu mungesa e kontroleve kompensuese në nivel komunal. Kjo ka shkaktuar të dhëna të pasakta për tatimpaguesit dhe pronat. *Mangësitë në kontrollet e përpunimit* kanë shkaktuar mos shpërndarjen e pagesës në mënyrë proporcionale dhe në borxhe të pasakta për qytetarin duke e dëmtuar me ndëshkime dhe interesa.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve nuk ka kontrole mjaftueshëm që sigurojnë plotësinë dhe saktësinë e rezultateve. Prandaj, Sistemi i Tatimit në Pronë ka mangësi në regjistrimin e pagesave dhe nuk e regjistron datën e saktë të kryerjes së pagesës, nuk e pasqyron gjendjen reale të faturës nuk mundëson pasqyrim dhe zbatim të saktë të kërkesave ligjore dhe rregullative. Si pasojë, qytetarët mund të penalizohen padrejtësisht me interesa pavarësisht pagesës në kohë, duke ulur besueshmërinë në sistemin tatimor. Proceset manuale rrisin rrezikun e gabimeve dhe humbjes së të dhënave jashtë sistemit.

Mangësitë në kontrollet e sigurisë së sistemit të tatimit në pronë e bëjnë më të cenueshëm ndaj keqpërdorimeve të sigurisë së informacionit në sistemin e tatimit në pronë. Edhe pse sistemi gjeneron gjurmë të auditimit, mungesa e plotësisë dhe e monitorimit të rregullt të tyre rrit rrezikun e ndryshimeve të paautorizuara ose gabimeve, duke cenuar transparencën, integritetin dhe besueshmërinë e sistemit. Mungesa e standardizimit dhe kontrollit të qasjes, si dhe mungesa e një mekanizmi të centralizuar për menaxhimin e kredencialeve, rrit rrezikun e qasjes së tepërt, duplikimeve dhe emërtimeve të paqarta të përdoruesve. Dërgimi i fjalëkalimeve përmes emailit shton rrezikun e qasjes së paautorizuar.

Prandaj, rreziqet e identifikuara më lartë, tregojnë që Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe Komunitat që administrojnë dhe ofrojnë shërbime përmes Sistemit të Informacionit për Tatimin në Pronë kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme, në mënyrë që të sigurohet zhvillimi i sistemit, mbrojtja e të dhënave dhe funksionimi i pandërprerë i shërbimeve të tatimpaguesve. Lidhur me këtë, kemi dhënë gjithsej 14 rekomandime, nga të cilat 13 rekomandime për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe 1 rekomandim për Komunitat. Lista e rekomandimeve, është paraqitur në Kapitullin 5 të këtij raporti.

Përgjigja e entiteteve

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Komunitat e Prishtinës janë pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit si dhe janë zotuar se do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje

Tatimi në pronë në Kosovë është një nga burimet kryesore të të hyrave vetanake për komunat dhe përbën një instrument të rëndësishëm për financimin e shërbimeve publike lokale, si ndriçimi publik, mirëmbajtja e rrugëve, pastrimi dhe investimet kapitale në infrastrukturë. Ky tatim aplikohet mbi të gjitha pronat e paluajtshme – përfshirë ndërtesat dhe tokat – pa marrë parasysh destinimin e tyre (banesor, afarist, bujqësor apo industrial).

Baza ligjore për administrimin e tatimit në pronë përcaktohet nga Ligji Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, si dhe aktet nënligjore që nxirren nga Ministria e Financave për zbatimin praktik të tij. Ky ligj përcakton përgjegjësitë e qarta për institucionet qendrore dhe lokale, si dhe proceset për regjistrim, vlerësim, faturim dhe mbledhje të tatimit.

Sistemi i tatimit në pronë është një prej sistemeve kryesore të grumbullimit të tatimit. Përmes tij deri më tani janë regjistruar 607,443,326 euro për gjithsej 817,040 njësi të objekteve dhe 2,258,838 njësi të parcelave, aktuale deri në vitin 2025, pasi që ofron shërbimet e pagesës së tatimit në mënyrë elektronike, duke e bërë më të qasshëm, më transparent dhe më efikas këtë proces. Sistemi për tatim në pronë ka ndërlidhje dhe ofrohet si shërbim në platformën elektronike e-Kosova, duke mundësuar ofrimin e faturave: Faturën e tatimit të pronës individuale; Faturën e tatimit të pronës për persona të tjerë; Faturën e tatimit të pronës së biznesit.

Ministria e Financave, përmes Departamentit për Tatimin në Pronë, ka rol udhëheqës dhe mbikëqyrës në administrimin e sistemit tatimor në pronë në nivel vendi. Ajo mban dhe mirëmban regjistrin qendror të pronës, publikon të dhëna dhe informacione, kryen vlerësime tatimore dhe ligjore, si dhe ndërmerr masa ndaj komunave në rast të shkeljeve. Gjithashtu, Ministria ofron udhëzime dhe interpretime ligjore për zbatimin uniform të legjislacionit dhe shqyrton ankesat për certifikatat e vlerësimit të lëshuara nga komunat.

Komunat, ndërkohë, janë përgjegjëse për administrimin operativ të tatimit në pronë në territorin e tyre. Ato regjistrojnë pronat, kryejnë inspektime në terren, klasifikojnë pronat sipas përdorimit, lëshojnë faturat, mbledhin pagesat dhe shqyrtojnë kërkesat për shtyrje apo rimbursim. Njësitë përkatëse në komuna bashkëpunojnë ngushtë me Ministrinë për vlerësimin e pronës dhe janë përgjegjëse për trajtimin e ankesave dhe ndërmarrjen e masave në rastet e mosrespektimit të detyrimeve tatimore nga tatimpaguesit. Tatimi në pronë është tatim vjetor, të cilin e vendos komuna.




Figura 1. Shërbimi i tatimit në pronë i ofruar për qytetarët në formë elektronike.

Faturë e tatimit në pronë – është dokument zyrtar që lëshohet nga komuna për të njoftuar tatimpaguesin dhe/ose debitorin për përgjegjësinë e tij për të paguar detyrimet tatimore.

Faturat e tatimit në pronë janë dizajnuar të paguhesh në dy këste brenda vitit pa u ndëshkuar me interes dhe gjobë. Kësti i parë paguhet deri me 30 prill dhe kësti i dytë deri me 30 shtator.

Pas datës për pagesë, aplikohet një interes prej 0.65% për muaj dhe një gjobë prej 10% për tatimin e papaguar.

Tatimi në pronë fillimisht ishte i fokusuar vetëm në objekte, ndërsa më pas u zgjerua edhe në tatimin mbi tokën. Në vitin 2018 u bë unifikimi i pronave për tatimpaguesit dhe për herë të parë u lëshua një faturë unike që sistemi duhej ta shpërndante automatikisht nëpër prona. Ky proces është financuar nga SIDA suedeze që nga viti 2008, megjithatë ekipi zhvillues i sistemit i kontraktuar nga SIDA nuk e realizoi kontratën dhe u largua 3 muaj para kohe, pa proces dorëzim-pranimi, pa dorëzim standard të kodit burimor si dhe plani i ri zhvillimor i sistemit nuk u realizua nga SIDA, që e vështirësoi mirëmbajtjen e sistemit.

Ekipi i ri për menaxhimin e sistemit, arriti gjenerimin e tatimit për vitin 2022 brenda afatit ligjor. Por, mbetën sfida të mëdha që lidhen me përditësimin e arkitekturës së sistemit, teknologjitë e vjetra të përdorura dhe mungesën e profileve të specializuara, etj.

2 Objektivi dhe fushat e auditimit

Objektivi i auditimit është të vlerësohet nëse palët përgjegjëse për menaxhimin e sistemit të tatimit në pronë sigurojnë se sistemi ofron të dhëna cilësore, të sakta, të plota dhe të besueshme.

Me këtë auditim, synojmë të ofrojmë rekomandime relevante për MFPT-në, me qëllim përmirësimin e nevojave për sistemin e tatimit në pronë.

Fushat e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektivit të auditimit, jemi fokusuar në fushën e zhvillimit dhe kontrollet e aplikacionit, duke i përzgjedhur fushat e auditimit si në vijim:

Tabela 2: Fushat dhe çështjet e auditimit

Fushat e auditimit	Çështjet e auditimit
1. Zhvillimi dhe Blerja	1. Sigurimi dhe Testimi i Cilësisë
	2. Menaxhimi i konfigurimit
2. Kontrollet e Aplikacionit	3. Kontrollet e hyrjes
	4. Kontrollet e përpunimit
	5. Kontrollet e të dhënave dalëse
	6. Kontrollet e sigurtisë së aplikacionit

Fushëveprimi i këtij auditimi është MFPT-ja, me fokus të veçantë Departamenti i Tatimit në Pronë, i cili është përgjegjës për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e punëve për zbatimin e ligjit për tatimin në pronë e paluajtshme dhe akteve nënligjore të nxjerra për zbatimin e tij, në të gjitha komunat e Kosovës, si dhe divizionet e këtij departamenti, të cilat janë: Divizioni për Inspektim, Divizioni për Çështje Ligjore të Tatimit në Pronë dhe Divizioni për Informim, Edukim dhe Shërbime Përkrahëse. Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informativë dhe Komuna e Prishtinës - Drejtoria e Pronës.

Fokus i auditimit është blerja dhe zhvillimi dhe kontrollet e aplikacionit për sistemin e tatimit në pronë. Auditimi mbulon periudhën nga janari i vitit 2024 deri në përfundim të auditimit.

3 Gjetjet e auditimit

Sistemi i tatimit në pronë është një nga sistemet kryesore për grumbullimin e tatimit, me mbi 607 milionë euro të regjistruara deri në vitin 2025 për mbi 817 mijë objekte dhe mbi 2.2 milionë parcela. Ai ofron pagesa elektronike, duke e bërë më të qasshëm, efikas dhe transparent, si dhe është i ndërlidhur me platformën e-Kosova për ofrimin e faturave për individë, persona të tjerë dhe biznese.

Gjetjet e dalura nga ky auditim ndërlidhen me zhvillimin dhe blerjen, dhe kontrollet e aplikacionit. Gjetjet janë të strukturuar sipas fushave dhe çështjeve të auditimit.

Zhvillimi dhe Blerja

- MFPT nuk zbaton procedurë për realizimin e testimeve për ndryshimet e realizuara në Sistemin e Tatimit në Pronë.
- Menaxhimi i konfigurimit aprovimi dhe refuzimi i zhvillimit në sistem.
- MFPT ka mangësi në menaxhimin dhe trajtimin e kërkesave për SITP.

Kontrollet e Aplikacionit

- Mangësi në të dhënat hyrëse nga Agjencia Kadastrale në Sistemin e Tatimit në Pronë.
- Mangësi në ndërlidhjen e Sistemit të Anketimit me SITP.
- Mungesë e kontrolleve kompensuese për regjistrimin e të dhënave në SITP në nivel komunal.
- Mos shpërndarja e pagesës në mënyrë proporcionale shkakton që borxhi të mos fshihet plotësisht.
- Sistemi i Tatimit në Pronë ka mangësi në regjistrimin e pagesave dhe nuk e regjistron datën e saktë të kryerjes së pagesës.
- Sistemi i Tatimit në Pronë nuk e pasqyron gjendjen reale të faturës.
- Sistemi i Tatimit në Pronë nuk mundëson pasqyrim dhe zbatim të saktë të kërkesave ligjore dhe rregullative
- MFPT-ja ka mangësi në monitorimin dhe menaxhimin e gjurmëve të auditimit.
- Në Sistemin e Tatimit në Pronë ka mungesë të standardizimit dhe unifikimit të përdoruesve.

Figura 2. Struktura e çështjeve të auditimit të sistemit të tatimit në pronë

Sistemi SITP është zhvilluar në mënyrë statike, pa strukturë të qartë dhe pa dokumentim, duke sjellë varësi nga zhvilluesit individualë. Ndryshimet e shpeshta në ekip kanë çuar në rishkrime të përsëritura të funksioneve, duke e bërë kodin të vështirë për mirëmbajtje dhe jo të shkallëzueshëm. Këto kufizime funksionale dhe teknike e kanë ndikuar që MFPT të zhvillojë një sistemi të ri, më të adaptueshëm ndaj ndryshimeve dhe të qëndrueshëm.

Pjesa e parë e paraqitur në kapitullin mbulon çështjet e identifikuara e që kanë nevojë për përmirësim që lidhen me sigurimin dhe testimin e cilësisë dhe me menaxhimin e konfigurimit.

Pjesa e dytë që është paraqitur mbulon çështjet e identifikuara që lidhen me kontrollet e hyrjes, kontrollet e përpunimit, kontrollet e të dhënave dalëse dhe kontrollet e sigurisë së aplikacionit.

3.1 Blerja dhe Zhvillimi

Zhvillimi, blerja dhe kontraktimi i jashtëm, sigurojnë se menaxhimi i kërkesave, analizimi dhe prioritizimi, mbështesin në vazhdimësi plotësimin e nevojave të përdoruesve në mënyrë optimale për zhvillimin e shërbimeve në Sistemin e Tatimit në Pronë.⁶




Figura 3. Blerja dhe Zhvillimi

1. MFPT nuk zbaton procedurë për realizimin e testimeve për ndryshimet e realizuara në Sistemin e Tatimit në Pronë

MFPT duhet të kryej testimet mbi sistemet TI-së dhe duhet të bazohet mbi rezultatet për pranimin ose refuzimin e sistemit.⁷

MFPT nuk zbaton procedurë që përcakton procesin, formën dhe mënyrën e testimit. Testimin për zhvillimin e sistemit e realizojnë vetë zhvilluesit e sistemit.

Ndërsa nga ana biznesore nga komplet Departamenti i Tatimit në Pronë në MFPT, kërkohet përmes emailit që të realizojnë testime në linjet testuese, në disa raste përfshihen edhe disa zyrtarë nga Komunitat. Ky proces nuk zhvillohet sipas një procedure standarde, nuk krijon një raport standard për rezultatet e testimit.

Pas testimit, zyrtarët që kanë kryer testime i drejtohen Departamentit të TI-së dhe zhvilluesit në email me rezultatet e testimit, i cili në raste të caktuara i kontakton edhe diskuton për rezultatet derisa arrin në rezultatin e kërkuar. Ekziston një draft procedurë për menaxhimin e ndryshimeve në të cilën përfshihet edhe forma e testimit, por asnjë nga zyrtarët që realizonin testime nuk janë të njohur me këtë procedurë. Për më tepër as divizionet brenda Departamentit të TI-së nuk përfshihen në testim siç është Divizioni i Infrastrukturës dhe Sigurisë për testimin e sigurisë së ndryshimit, performancën e serverave dhe 'testin e stresit' të përdorimit.

MFPT ka të përcaktuara përgjegjësitë për testimin e sistemit në Divizionin e Inspektimit, si dhe një procedurë për menaxhimin e ndryshimeve, e cila mbetet vetëm draft dhe nuk zbatohet. Në praktikë,

⁶ Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit, Zhvillimi, Blerja dhe Kontraktimi i jashtëm.

⁷ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit –Blerja dhe zhvillimi

testimi nga ana e biznesit kryhet nga i gjithë Departamenti i Tatimit në Pronë, për shkak të mungesës së zyrtarëve të dedikuar.

Ndërsa nga ana e TI-së, nuk ka tjera resurse përveç zhvilluesve që realizojnë testim për pjesën që kanë zhvilluar pa krijuar një dokumentim apo raportim.

Nuk arrijnë të sigurojnë se zhvillimi plotëson nevojat e biznesit dhe sigurisë së informacionit dhe performancës. E për më tepër problemet në aplikacion arrijnë t'i identifikojnë vetëm një kohë pas përdorimit. Sikur që kemi shembujt të bashkimi i faturave dhe mos shpërndarja e mirë e pagesës së borxhit për të gjitha pronat, brenda një fature. Pastaj, ndërlidhja e bazës së të dhënave me Agjencinë Kadastrale që ka mbishkruar të dhënat e SITP me të dhëna të pa përditësuara si dhe shfrytëzimi jo proporcional i resurseve harduerike të procesimit nga ana e sistemit të zhvilluar mos-përputhshmërisht me standardet për zhvillimin e aplikacioneve.

2. Menaxhimi i konfigurimit aprovimi dhe refuzimi i zhvillimit në sistem

Vetëm ndryshimet e autorizuara dhe të aprovuara do të prezantohen në mjedisin prodhimit.⁸

Pas zhvillimit të kërkesave të biznesit në Sistemin e Tatimit në Pronë, zhvilluesit praktikisht duhet edhe të vendosin nëse janë bërë mjaftueshëm teste. Bazuar në emailat që pranojnë nga zyrtarët e Departamentit të Tatimit në Pronë dhe testeve që i realizojnë edhe vet zhvilluesit në praktikë. Pastaj, ata vetë vlerësojnë nëse ndryshimi është i gatshëm për vendosjen në ambientin real të prodhimit.

MFPT nuk krijon ndonjë dokument aprovues të ndryshimeve, po ashtu nuk ka procedurë standarde për aprovimin e ndryshimeve të miratuar dhe në zbatim, por gjithashtu nuk ka ndonjë vendim apo ndarje përgjegjësie për aprovimin e ndryshimeve nga një pozitë përkatëse me autoritet aprovues në Departamentin e Tatimit në Pronë. Përveç mungesës së procedurës MFPT e arsyeton edhe me mungesën e resurseve njerëzore të përgatitura me kompetencë dhe njohuri të kombinuara të biznesit dhe TI-së.

Si pasojë nuk bëhet menaxhim i mirë i resurseve dhe proceseve, krijohen konflikte përgjegjësish dhe ikje nga përgjegjësia. Zhvilluesit ngarkohen edhe me vlerësimin e punës së vetë. Që përveç që ndikon në performancën e zhvilluesve ka edhe konflikt përgjegjësish dhe mungesë monitorimi.

3. MFPT ka mangësi në menaxhimin dhe trajtimin e kërkesave për SITP

Vetëm ndryshimet e autorizuara dhe të aprovuara do të prezantohen në mjedisin prodhimit.⁹

MFPT në mungesë të menaxhimit jo të mirë të kërkesave nuk arrijnë të i shqyrtojnë të gjitha kërkesat për problemet që ka sistemi. Kryesisht kërkesat pranohen nga komunat përmes emailit në Divizionin për Informim, Edukim dhe Shërbime përkrahëse, përkatësisht Tavolina ndihmëse si pjesë e këtij divizioni. Këta i vendosin kërkesat në sistemin e tiketave për t'i pranuar zhvilluesit. Sistemi i tiketave është një sistem i gatshëm për menaxhimin e tiketave, i cili sistem ofron mundësi që përfshijnë statusin, nivelin e kritikalishtit dhe prioritizimit të kërkesës. Mirëpo, këto mundësi nuk shfrytëzohen nga MFPT. Prandaj, kërkesat mbesin të pa identifikuar se çfarë statusi të zgjidhjes kanë. Si pasojë shpesh edhe parashtuesi fillestar i kërkesës mbetet pa përgjigje rreth asaj kërke.

⁸ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit –Blerja dhe zhvillimi

⁹ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit –Blerja dhe zhvillimi

Gjithashtu nuk identifikohet numri i kërkesave që janë zgjidhur dhe që kanë mbetur të pazgjidhura si dhe zgjidhja e kërkesave më me pak prioritet kundrejt atyre më kritike.

Mungesa e një procedure për trajtimin e kërkesave i lë të pa informuar zyrtarët përgjegjës dhe zhvilluesit për përcaktimin e prioritetit të zgjidhjes dhe kritikalitetit të kërkesës, si dhe statusit të zgjidhjes së kërkesës dhe përcjelljes së informacionit deri te parashtruesi i kërkesës.

Si pasojë nuk bëhet menaxhim i mirë i kërkesave, ka vonesa në realizimin e kërkesave apo edhe mbesin pa u trajtuar kërkesa kritike dhe me shumë prioritet. Por edhe në rast të zgjidhjes apo pa mundësisë së zgjidhjes MFPT dhe komunat mbesin të pa informuar me statusin e atyre kërkesave.

3.2 Kontrollet e aplikacionit

Kontrollet e aplikacionit janë: kontrolli mbi funksionin e hyrjes, të përpunimit, të daljes dhe sigurisë. Ato përfshijnë metoda për të siguruar që: vetëm të dhëna të plota, të sakta, të vlefshme dhe të besueshme vendosen dhe azhurnohen në një sistem të informacionit, përpunimi realizon detyrën e saktë dhe rezultati i përpunimit plotëson pritjet dhe të dhënat ruhen.¹⁰




Figura 4. Kontrollet e aplikacionit

4. Mangësi në të dhënat hyrëse nga Agjencia Kadastrale në Sistemin e Tatimit në Pronë.

Rregullat e vlefshmërisë duhet të jenë të mirë-hartuara, të dokumentuara dhe të zbatuara në ndërveprimin e hyrjeve (inputit); duhet të dokumentohen metoda të ndryshme për futjen e të dhënave; të dhëna jo valide duhet të refuzohen në mënyrën e duhur nga aplikacioni; kriteret e vlefshmërisë përditësohen në mënyrën e duhur dhe të autorizuar; duhet të ekzistojnë kontrole gjithëpërfshirëse si rregulla regjistrimi dhe autorizimi në rast të mundësisë së kontroleve thelbësorë të hyrjes; ka kontrole dhe dokumentim të duhur për hyrjet e aplikacionit.¹¹

Që nga viti 2019, MFPT kryen përditësim vjetor të të dhënave të Sistemit të Tatimit në Pronë (SITP) me të dhënat e parcelave nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK). Deri në vitin 2023, këto

¹⁰ Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit, Kontrollet e aplikacionit

¹¹ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e hyrjes.

përditësime kanë mbishkruar të gjitha të dhënat ekzistuese. Por kjo ka anuluar regjistrimet e komunave gjatë vitit, për shkak të mungesës së regjistrimeve të ndarjes së parcelave në kadastrë.

Në vitin 2023, MFPT ndërmori veprime duke hartuar rregulla të reja për të filtruar vetëm regjistrimet e reja vjetore. Megjithatë, SITP vazhdon të pranojë të dhëna të pasakta nga AKK, pasi mungon standardizimi dhe validimi i identifikuesve të tatimpaguesve – duke përdorur herë numrin personal e herë identifikuesin “kcid”.

Mungesa e validimit dhe standardizimit të të dhënave në regjistrin kadastral ka bërë që tatimpaguesit të identifikohen herë me numër personal e herë me “kcid”, duke krijuar raste kur i njëjti person paraqitet si dy tatimpagues të ndryshëm.

Kjo sjell pasaktësi në të dhëna, pasqyrim të gabuar të borxhit, shpërndarje jo të saktë të pagesave dhe vështirësi në menaxhimin e tatimeve, duke ndikuar negativisht në procesin e mbledhjes së tyre.

5. Mangësi në ndërlidhjen e Sistemit të Anketimit me SITP

Rregullat e vlefshmërisë duhet të jenë të mirë-hartuara, të dokumentuara dhe të zbatuara në ndërveprimin e hyrjeve (inputit); duhet të dokumentohen metoda të ndryshme për futjen e të dhënave; të dhëna jo valide duhet të refuzohen në mënyrën e duhur nga aplikacioni; kriteret e vlefshmërisë përditësohen në mënyrën e duhur dhe të autorizuar; duhet të ekzistojnë kontrolle gjithëpërfshirëse si rregulla regjistrimi dhe autorizimi në rast të mundësisë së kontrolleve thelbësorë të hyrjes; ka kontrolle dhe dokumentim të duhur për hyrjet e aplikacionit.¹²

Zyrtarët regjistruar në komunë gjatë verifikimit dhe regjistrimit të pronave dhe tatimpaguesve në teren i regjistrojnë të dhënat përmes pajisjeve mobile në sistemin e anketimit, i cili sistem është i ndërlidhur me SITP dhe dërgon të dhënat në formë automatike përmes ndërlidhjes. Mirëpo, jo gjithmonë këto të dhëna dërgohen në SITP. Prandaj, kemi verifikuar nga mostrat e pranuar nga komuna e Prishtinës se të dhënat e Sistemit të anketimit nuk janë gjithmonë të njëjta me ato të SITP. Lokacioni i përzgjedhur në hartën e sistemit të anketimit nuk arrin të bartet në SITP dhe nuk ruhej opsioni i përzgjedhur si banim primar në sistemin e anketimit, kjo nuk regjistrohej dhe nuk dërgohej përmes ndërlidhjes në SITP.

Këto probleme shkaktohen nga mos funksionimi i mirë i ndërlidhjes, ueb-serviseve dhe përditësimi i hartave të përdorura në këto dy sisteme në versionin e njëjtë.

Si rezultat krijon ngarkesë dhe punë të dyfishtë për zyrtarin regjistruar në komunë dhe mundësi më të madhe të gabimit pas regjistrimit manual në SITP.

6. Mungesë e kontrolleve kompensuese për regjistrimin e të dhënave në SITP në nivel komunal

Në aplikacion duhet të ketë të vendosura nivelet e autorizimit të transaksioneve dhe duhet të zbatohen nëpërmjet kontrolleve të ndryshme; të ekzistojnë ndarje e saktë e detyrave për futjen e të dhënave; të ekzistojnë kontrolle kompensues për rastet në të cilat ndarja e detyrave nuk është e mundur.¹³

Në sistemin SITP të dhënat për pronat dhe tatimpaguesit regjistrohen nga zyrtarët për regjistrim në komuna. Ekziston rol i veçantë në SITP për zyrtarët që regjistrojnë të dhënat. Poashtu, këta zyrtarë dalin në teren për verifikimin e pronave dhe marrin të dhënat në teren të cilat i regjistrojnë përmes

¹² Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e hyrjes.

¹³ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e hyrjes.

pajisjeve mobile në sistemin e anketimit, i cili sistem është i ndërlidhur me SITP dhe dërgon të dhënat në formë automatike përmes ndërlidhjes.

Mirëpo, nuk realizohet rishikim si kontroll kompensues për regjistrimet që realizojnë zyrtarët regjistruar. Edhe pse ekzistojnë role mbikëqyrëse në sistemin SITP dhe krijohet histori e aktiviteteve për përdoruesit regjistruar në të cilën histori mbikëqyrësi i tyre i drejtpërdrejt ka qasje ta monitoroj, por nuk ka qasje të aprovoj regjistrimin prandaj ata nuk e përdorin për rishikim.

MFPT dhe Komuna e Prishtinës këtë mungesë të kontrollit e arsyetuan, që mjafton qasja monitoruese nga Divizioni i Inspektimit të Tatimit në Pronë në MFPT. Por e cila kontroll nuk është kompensuese pasi që realizohet në baza vjetore me vlerësim të rrezikut dhe mostrim të kufizuar pa kontrolluar komplet popullacionin.

Prandaj, si mungesë e kontrolleve kompensuese kërkuam mostrat e verifikuara nga Divizioni i Inspektimit të Tatimit në Pronë në MFPT të cilat përmbanin gabime në regjistrim si mungesa e regjistrimit të banimit primar që rezultonte të dëmtonte tatimpaguesin në mungesë të zbritjes për banimin primar, si dhe ngatërrimi i normës tatimore, që mund të dëmtonte tatimpaguesin apo edhe komunën.

7. Mos shpërndarja e pagesës në mënyrë proporcionale shkakton që borxhi të mos fshihet plotësisht

Transaksionet e aplikacionit duhet të ekzekutohen në përputhje me sjelljen e pritur¹⁴ Transaksionet e aplikacionit duhet të ekzekutohen në mënyrë të kontrolluar dhe të besueshme, duke siguruar që ato të përputhen me rregullat e biznesit, parametrat e konfigurimit dhe skenarët e parashikuar të përpunimit.¹⁵

Sistemi i Tatimit në Pronë nuk siguron përpunimin e të dhënave të plota, të sakta dhe të besueshme. Në Komunën e Prishtinës kemi vërejtur se pagesat e bëra në Sistemin e Tatimit në Pronë nuk shpërndahen në mënyrë proporcionale kur janë dy e më shumë prona në një faturë të pronarit të njëjtë. Në rastet kur tatimpaguesi ka kryer pagesën shpërndarja nuk është bërë në të gjitha pronat në mënyrë të barabartë, por në disa prona ka figuruar si parapagim (me plus) ndërsa në disa prona figuron si borxh.

Në rastin tjetër qytetari ka paguar gjithë borxhin madje ka hyrë në parapagim, mirëpo në vitin pasues ka figuruar me borxh në faturë. Pas ankesës së qytetarit zyrtarët komunal kanë reaguar të Departamenti i Tatimit në Pronë në MFPT dhe është shlyer borxhi. Këto gabime dhe pasaktësi në sistem shkaktojnë ngarkesë me interes dhe gjorbë për qytetarët dhe tregojnë se sistemi nuk ka kontrolle të mjaftueshme për përpunimin e të dhënave. Zyrtarët e Komunës së Prishtinës nuk ishin në gjendje të shpjegojnë arsyen e ndodhjes së këtyre gabimeve në sistem. Mirëpo, zhvilluesit e sistemit në MFPT shpjeguan qartë se kjo ndodhë si pasojë e bashkimit të faturave për një tatimpagues mënyra e zhvillimit të kodit për këtë pjesë është shumë statike dhe është rishikuar disa herë funksioni si rezultat i ndryshimeve në ekipën zhvilluese dhe mos krijimi i dokumentimit. Problemet e vazhdueshme për shkak të pamundësisë së ndryshimeve në kod dhe shkallëzueshmërisë së kodit janë ndër shkaqet që kanë shtyrë MFPT-në të zhvilloj sistem të ri.

¹⁴ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollat e Aplikacionit, Kontrollat e përpunimit

¹⁵ Përdorimi i udhëzimeve të COBIT (sidomos DSS05 dhe BAI09) për kontrollin e proceseve dhe sigurimin e besueshmërisë së përpunimit të transaksioneve.

Si rezultat i kësaj, qytetarët përballen me borxhe të pasakta, si dhe aplikime të interesave dhe ndëshkimeve pa të drejtë duke dëmtuar financiarisht tatimpaguesit dhe duke rritur volumin e ankesave. Kjo ka krijuar mungesë besueshmërie të qytetarëve ndaj sistemit.

8. Sistemi i Tatimit në Pronë ka mangësi në regjistrimin e pagesave dhe nuk e regjistron datën e saktë të kryerjes së pagesës.

Organizata duhet të ketë të hartuara procedurat për të siguruar se plotësia dhe saktësia rezultateve të aplikacioneve është vlerësuar përpara përdorimit të rezultatit nga përpunimi i mëtejshëm, përfshirë përpunimin e përdoruesve final; të mundësohet gjurmimi i rezultatit të aplikacionit; rezultati të rishikohet për arsyeshmëri dhe saktësi; kontrollet e plotësisë dhe të saktësisë të jenë efektive.¹⁶

Sistemi i Tatimit në Pronë nuk e merr datën e realizimit të pagesave që bëhen për tatimin në pronë. Lidhur me pagesat për tatimin në pronë, Sistemi i Tatimit në Pronë i shfrytëzon të dhënat nga Thesari dhe në rast se qytetari e realizon pagesën në ditën e fundit të afatit kohor (23:59h), pagesa nuk procesohet menjëherë nga Thesari. Te pagesat që realizohen përmes platformës e-Kosova, data e realizimit të pagesës vjen në kohë reale, mirëpo Sistemi i Tatimit në Pronë, si të mirëqena, i merr vetëm të dhënat që vijnë nga Thesari, e njëjta situatë është edhe me format tjera të pagesës siç janë e-banking apo pagesa direkte në institucione financiare. Si pasojë borxhi fshihet vetëm atëherë kur pagesa arrin si e hyrë në sistemin e të hyrave në Thesar, ndërsa deri atëherë qytetarit fillon t'i kalkulohet interesi, edhe pse ai e ka bërë pagesën brenda afatit të përcaktuar me ligj.

Përveç kësaj, mangësi tjetër në regjistrimin e pagesës është edhe pamundësia e validimit të UNIREF-it gjatë regjistrimit të pagesës që rezulton me realizimin e pagesës me UNIREF të pasaktë apo pa UNIREF. Poashtu kemi hasur në raste kur pagesa nuk i përmban të gjitha elementet e pagesës dhe në mungesë të validimit, ajo pagesë nuk shkon në adresën e duhur por përfundon te pagesat e dështuara. Këto pagesa trajtohen manualisht nga zyrtarët përgjegjës për procesim të pagesave. Për më tepër, ka raste që jo të gjitha këto pagesa të parregullta paraqiten te pagesat e dështuara, duke sjellë punë shtesë për zyrtarët për t'i verifikuar.

Nga Sistemi i Tatimit në Pronë, të dhënat për pagesën nuk merren në kohë reale me ndërlidhje direkte nga institucionet përkatëse financiare, lidhur me kohën e pagesës (inimin e pagesës), si dhe nuk bëhet validimi i UNIREF-it për pagesë.

Si pasojë, qytetarit mund t'i ngarkohet interes i padrejtë për vonesë, edhe pse ai e ka kryer pagesën brenda afatit ligjor. Dhe të penalizohen pa fajin e tyre, duke krijuar besueshmëri të ulët në sistemin tatimor.

9. Sistemi i Tatimit në Pronë nuk e pasqyron gjendjen reale të faturës.

Organizata duhet të ketë të hartuara procedurat për të siguruar se plotësia dhe saktësia rezultateve të aplikacioneve është vlerësuar përpara përdorimit të rezultatit nga përpunimi i mëtejshëm, përfshirë përpunimin e përdoruesve final; të mundësohet gjurmimi i rezultatit të aplikacionit; rezultati të rishikohet për arsyeshmëri dhe saktësi; kontrollet e plotësisë dhe të saktësisë të jenë efektive.¹⁷

Sistemi i Tatimit në Pronë nuk përmban kontrolle që sigurojnë plotësinë dhe saktësinë e rezultateve. Në SITP kemi vërejtur një rast ku qytetari ka borxh për tatimin në pronë në vlerë prej 3,047.92 euro

¹⁶ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e të dhënave dalëse

¹⁷ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e të dhënave dalëse

që figuron në sistem, ndërsa në faturë shfaqet zero borxh. Nga dëshmitë e siguruara shihet se në sistem po kalkullohet kamata dhe dënimi, mirëpo në faturën përfundimtare kjo vlerë shfaqet si zero.

Në këtë parcelë është regjistruar dy herë i njëjti tatimpagues si posedues, prandaj njëri është fshirë me të cilin është kalkuluar borxhi që figuron në sistem dhe tjetri ka mbetur me faturën zero.

Në disa raste, kur qytetari ka paguar më shumë se borxhi për tatimin në pronë, pas kthimit të shumës së tepërt nga institucioni, sistemi vazhdon ta regjistrojë pagesën si të përfunduar dhe njëkohësisht si parapagim. Gjithashtu, kemi edhe disa raste të pagesat e rregullta që regjistrohen gabimisht edhe si parapagime, duke rezultuar që i njëjti borxh të shlyhet dhe të krijohet parapagim për të njëjtën shumë. Këto pasaktësi kërkojnë ndërhyrje manuale nga zyrtarët përkatës për t'u korrigjuar.

Kjo ndodhë si shkak që sistemi është i ndërtuar me rishkrime të shumta të funksioneve në kod, gjë që e bën të paoptimizuar dhe konsumon plotësisht kapacitetin e tij procesues, duke shkaktuar gabime në llogaritje dhe përpunim të të dhënave, të cilat janë të vështira për t'u identifikuar dhe zgjidhur edhe nga vetë zhvilluesit. Për shkak të pamundësisë për të identifikuar dhe rregulluar këto probleme të shumta në sistemin ekzistues, zgjidhja e propozuar nga ekipi zhvillues dhe miratuar nga MFPT ka qenë ndërtimi i një sistemi krejtësisht të ri.

Në mungesë të pagesës, për të cilën qytetari nuk është në dijeni se ka obligim për tatim, atij fillon t'i llogaritet kamata dhe dënimi për shumën e papaguar. Kjo ndodh për shkak se fatura figuron si zero dhe nuk pasqyrohet borxhi real. Për pasojë, ai nuk arrin ta kryejë pagesën me kohë, pasi nuk shfaqet saktë borxhi në faturë.

10. Sistemi i Tatimit në Pronë nuk mundëson pasqyrim dhe zbatim të saktë të kërkesave ligjore dhe rregullative.

Organizata duhet të ketë të hartuara procedurat për të siguruar se plotësia dhe saktësia rezultateve të aplikacioneve është vlerësuar përpara përdorimit të rezultatit nga përpunimi i mëtejshëm, përfshirë përpunimin e përdoruesve final; të mundësohet gjurmimi i rezultatit të aplikacionit; rezultati të rishikohet për arsyeshmëri dhe saktësi; kontrollat e plotësisë dhe të saktësisë të jenë efektive.¹⁸

SITP nuk mundëson zbatimin e neneve të Ligjit për Tatimin në Pronë si në vijim: Neni 8 Rregullat e klasifikimit; Neni 25 Shtyrja e Pagesës; Neni 27 Njoftimi përfundimtar; Neni 34 Rimbursimi; Neni 35 Gjobat, gjithashtu SITP nuk përkrahë zbatimin e llogaritjes së normës tatimore progresive. Gjë që i detyron zyrtarët të funksionojnë ende me procese manuale, si dhe të nxjerrën vendime për shtyrjen e zbatimit të pjesëve të caktuara të ligjit.

Këto mangësi në sistem janë si shkak i mënyrës së zhvillimit të kodit në formë statike pa mundësi zgjerueshmërie, po ashtu kanë ndikuar ndryshimet në ekipën zhvilluese dhe mos krijimi i dokumentimit. Prandaj, problemet e vazhdueshme për shkak të pamundësisë së ndryshimeve në kod dhe shkallëzueshmërisë së kodit kanë shtyrë MFPT-në të zhvillojë sistem të ri.

Zbatimi i proceseve në formë manuale rrit mundësinë e gabimit dhe krijon mundësi për humbje të informacionit të trajtuar jashtë sistemit të informacionit.

¹⁸ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollat e Aplikacionit, Kontrollat e të dhënave dalëse

11. MFPT-ja ka mangësi në monitorimin dhe menaxhimin e gjurmëve të auditimit

Duhet të ekzistojnë gjurmë të mjaftueshme auditimit që kapin modifikimet, regjistrimet e autorizuar të transaksioneve kritike; gjurmët e auditimit rishikohen periodikisht për të monitoruar aktivitetet jonormale; gjurmët e auditimit mirëmbahen dhe ruhen në mënyrën e duhur; numra unikë dhe sekuencialë, ose identifikues duhet të jenë të përcaktuar për çdo transaksion.¹⁹

MFPT-ja nuk bën monitorimin e aktiviteteve në sistem. Në bazën e të dhënave të sistemit të tatimit në pronë gjendet tabela e gjurmëve të auditimit, në të cilën ruhen çdo ndryshim, fshirje, editim apo aktivitet. Mirëpo, këto gjurmë nuk monitorohen. Qasje në tabelën e gjurmëve të auditimit kanë zhvilluesit për të parë rrjedhën e rasteve, por ai monitorim bëhet vetëm në raste të veçanta, kur ka ndonjë kërkesë për dyshime të ngritura, për të parë se si ka rrjedhur ngjarja. Për shkak të resurseve të kufizuara.

Gjurmët e auditimit në bazën e të dhënave nuk ofrojnë aftësi të mjaftueshme për të identifikuar me saktësi modifikimet e transaksioneve të kryera drejtpërdrejt në bazë, për shkak se numri identifikues në tabelë gjenerohet përmes mekanizmit të brendshëm të sekuencës (hibernate_sequence) për krijimin e identifikuesve unikë.

Poashtu brenda në sistemin e tatimit në pronë ruhen të gjitha aktivitetet dhe historia, por ka raste kur sistemi krijon permutacion të të dhënave mes dy kolonave duke ngatërruar vlerën e re me vlerën e vjetër.

Mungesa e gjurmëve të plota dhe të besueshme të auditimit, si dhe mungesa e monitorimit të tyre të rregullt, rrit rrezikun për manipulime, ndryshime të paautorizuara apo gabime të paidentifikuara. Po ashtu, pamundësia për të identifikuar modifikimet direkte në bazën e të dhënave dhe përdorimi i mekanizmit të sekuencës (hibernate_sequence) për gjenerimin e identifikuesve unikë e vështirëson dallimin midis transaksioneve legjitime dhe atyre të modifikuara manualisht, duke cenuar integritetin dhe besueshmërinë e të dhënave.

12. Në Sistemin e Tatimit në Pronë ka mungesë të standardizimit për krijimin e llogarive të unifikuara të përdoruesve.

Të dhënat e aplikacionit duhet të mbrohen në përputhje me standardet e sigurisë dhe manualin e auditimit të TI-së. Duhet të zbatohen kontrole efektive të qasjes logjike dhe fizike, siç përcaktohet në domainin mbi Sigurinë e Informacionit, për të siguruar autentifikimin, autorizimin dhe monitorimin e aksesit.²⁰

Në MFPT janë krijuar llogari pa ndonjë standard unifikimi dhe vazhdojnë ende të krijohen pa standard. MFPT e ka hartuar politikën në vitin 2021, por kjo politikë mbetet e aplikuar për llogaritë e SITP. MFPT-ja përdor një formular për kërkesa për regjistrimin e një zyrtari të ri me role përgjegjëse, së pari kërkesa vjen nga komuna te Departamenti i Tatimit në Pronë, ku ajo kërkesë paraqitet në një formular të plotësuar me të dhënat përkatëse. Pastaj ajo shqyrtohet nga drejtori dhe aprovohet, dhe më pas kërkesa përcillet nga Departamenti i Tatimit në Pronë te zyrtari i TI-së me rolin administrues në sistem për ta regjistruar në sistem dhe për t'ia caktuar rolet e kërkuara. Zyrtari i TI-së që e regjistron në sistem e përdor si praktikë që llogaria e përdoruesit të jetë me

¹⁹ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollët e Aplikacionit, Kontrollët e sigurisë së aplikacionit

²⁰ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollët e Aplikacionit, Kontrollët e sigurisë së aplikacionit

emer.mbiemer, ose një shkronjë e emrit dhe mbiemri, apo anasjelltas, por ka raste që përdoren edhe ndryshe, pasi që nuk ka një standardizim dhe nuk janë të integruar, apo validuar me domain.

Po ashtu, kur zyrtarët komunalë harrojnë fjalëkalimin, ata dërgojnë kërkesë të vulosur dhe të nënshkruar përmes emailit, e cila pastaj nënshkruhet nga drejtori i Departamentit të Tatimit në Pronë, dhe më pas zyrtari i TI-së e ekzekuton në sistem. Fjalëkalimi i gjeneruar i përcillet zyrtarit përmes emailit dhe nuk shkon direkt nga sistemi. Nuk shkon drejtpërdrejt, por parametrat dërgohen përmes emailit. Pastaj zyrtarët mund ta ndryshojnë fjalëkalimin pasi t'i kenë pranuar kredencialet në emailin e tyre.

Që nga zhvillimi i sistemit, që është bërë në vitin 2008 , e deri në vitin 2021 kur është miratuar Politika e Menaxhimit të Llogarive Elektronike, nuk ka pasur një politikë për unifikim dhe standardizim të përdoruesve, si dhe për integrimin e tyre në domain. Poashtu në mungesë të përditësimit të kësaj politike ka ndikuar edhe mungesa e stafit. Sistemi i Tatimit në Pronë nuk e gjeneron fjalëkalimin në mënyrë të automatizuar, ku zyrtari përgjegjës do të mund të krijonte një fjalëkalim të ri pa plotësuar formularin, por ta bënte këtë vetë përmes sistemit në mënyrë automatike.

Mungesa e kontrollit mbi qasjen dhe mekanizmit të centralizuar për menaxhimin e kredencialeve. Rrit rrezikun që përdoruesit të kenë qasje më shumë se sa që duhet si dhe të krijohen duplikime dhe emërtime të paqarta për monitorimin e lehtë të përdoruesit. Përcjellja e fjalëkalimeve përmes emailit rrit rrezikun e qasjes së paautorizuar. Po ashtu, nuk ka garanci që fjalëkalimi është përdorur vetëm nga personi i synuar.

4 Konkluzionet

Sistemi i Informacionit të Tatimit në Pronë (SITP) luan një rol të rëndësishëm në administrimin e tatimit në pronë dhe ofron mundësi për përmirësimin e proceseve. Megjithatë Sistemi i Tatimit në Pronë nuk garanton plotësisht ofrimin e të dhënave cilësore, të sakta, të plota dhe të besueshme. Dobësitë në zhvillim dhe funksionim të sistemit, mungesa e procedurave të standardizuara për testim dhe aprovime, si dhe kontrollet e pamjaftueshme, kanë ndikuar negativisht në integritetin e të dhënave dhe menaxhimin efikas të tatimit. Kjo ka rritur rrezikun për pasaktësi në llogaritje, shpërndarje të gabuar të pagesave dhe vështirësi në identifikimin e saktë të tatimpaguesve.

Blerja dhe zhvillimi

Mungesa e një procedure të standardizuar për organizimin e procesit të testimit të zhvillimeve dhe ndryshimeve në aplikacion ka rezultuar që MFPT nuk ka vendosur kontrole të mjaftueshme të brendshme për të siguruar që çdo zhvillim i realizuar në Sistemin e Informacionit të Tatimit në Pronë (SITP) përmbush qëllimin e tij dhe funksionon sipas kërkesave të përcaktuara.

Poashtu, kontroll i pamjaftueshëm mbi vendosjen e ndryshimeve në mjedisin e prodhimit në MFPT nuk siguron që vetëm ndryshimet e aprovuara të vendosen në ambientin real të prodhimit, për shkak të mungesës së procesit të monitorimit, aprovimit dhe/ose refuzimit të zhvillimeve para implementimit të tyre. Si dhe, menaxhimi joefektiv i kërkesave për zhvillim në MFPT siguron një proces efektiv për menaxhimin e kërkesave, i cili do të mundësonte një pasqyrë të saktë mbi statusin dhe prioritetin e tyre. Kjo kufizon aftësinë për të alokuar dhe shfrytëzuar në mënyrë optimale burimet në dispozicion.

Kontrollet e aplikacionit

Mangësitë e konsiderueshme në kontrollet e aplikacionit të Sistemit të Tatimit në Pronë (SITP), të cilat ndikojnë negativisht në saktësinë dhe plotësinë e të dhënave, si dhe në efikasitetin e proceseve. Të dhënat hyrëse nga ndërlidhja me Regjistrin Kadastral dhe sistemin e anketimit shpesh nuk janë të sakta dhe nuk sinkronizohen në mënyrë të duhur, duke shkaktuar dyfishime të tatimpaguesve, mospërputhje të pronarëve dhe nevojë për futje manuale të të dhënave, që rrit rrezikun e gabimeve. Mungesa e kontrolleve kompensuese në komuna krijon mundësi për gabime në vendosjen e banimit primar apo të normës tatimore gjatë regjistrimit.

Sistemi nuk ofron kontrole të mjaftueshme për përpunimin dhe vlefshmërinë e transaksioneve, duke ndikuar në shpërndarje jo të drejtë të pagesave të borxhit dhe ndëshkime dhe interesa të padrejta për qytetarët. Mospërdorimi i datës reale të pagesës, vonesat dhe dështimet në procesim për shkak të mungesës së validimit të UNIREF-it krijojnë situata ku tatimpaguesit mund të ngarkohen me interesa pavarësisht pagesës brenda afatit ligjor. Këto dobësi shfaqen edhe në mospasqyrimin korrekt të faturave, çka mund të çojë në kalkulim të padrejtë të kamatës ose dënimeve në vitin pasardhës, ndërsa mungesa e monitorimit pengon identifikimin automatik të rasteve problematike.

Kufizimet teknike të SITP, për shkak të pamundësisë për zgjerim dhe përshtatje të kodit ekzistues, kanë penguar zbatimin e disa neneve të Ligjit për Tatimin në Pronë, duke detyruar MFPT të zhvillojë një sistem të ri. Për më tepër, edhe pse sistemi regjistron gjurmët e auditimit për çdo veprim, ato nuk monitorohen rregullisht, duke kufizuar aftësinë për të zbuluar dhe parandaluar në kohë veprimet e paautorizuara ose gabimet.

Dobësi të tjera të rëndësishme lidhen me menaxhimin e përdoruesve dhe sigurinë e qasjes. Mungesa e aplikimit të politikës apo procedurës së standardizuar për krijimin dhe administrimin e përdoruesve, mungesa e validimit në domain dhe dërgimi i fjalëkalimeve përmes emailit rrisin rrezikun për komprometim të të dhënave dhe e bëjnë të vështirë gjurmimin e aktiviteteve. Këto mangësi e ekspozojnë sistemin ndaj keqpërdorimeve dhe ulin nivelin e përgjithshëm të sigurisë së tij.

5 Rekomandimet

Rekomandojmë Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe në koordinim me Komunitet qe:

1. **Procedura e testimit**, MFPT-ja të sigurojë miratimin dhe zbatimin e procedurës së detajuar për procesin e testimit duket përcaktuar formën, mënyrën, përgjegjësitë dhe të eliminoj konfliktet e përgjegjëseve. Si dhe të përcaktoj formën e dokumentimit të testimit.
2. **Aprovimi dhe refuzimi i zhvillimit**, MFPT-ja të sigurojë miratimin dhe zbatimin e procedurës për menaxhimin e ndryshimeve, të përcaktoj përgjegjësitë për aprovimin dhe refuzimin e ndryshimeve dhe të eliminoj konfliktet e përgjegjëseve.
3. **Menaxhimi dhe trajtimi i kërkesave**, MFPT-ja të sigurojë miratimin dhe zbatimin e procedurës për trajtimin e kërkesave, që përmes kësaj procedure të përcaktoj përgjegjësitë dhe të informoj zyrtarët përgjegjës për përcaktimin e nivelit të prioritetit të kërkesës, kritikabilitetit, statusit të zgjidhjes së kërkesës dhe kthimit të informatës.
4. **Të dhënat hyrëse nga Agjencia Kadastrale e Kosovës**, MFPT-ja në koordinim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës në marrëveshjen për migrimin e të dhënave të sigurojë që nga Agjencia Kadastrale e Kosovës të i ofrohen vetëm të dhëna të validuara dhe të sakta për tatimpaguesin me numër personal të vlefshëm pa krijuar dyfishim të tatimpaguesve.
5. **Të dhënat hyrëse nga Sistemi i Anketimi**, MFPT-ja të sigurojë që ndërlidhja mes sistemit të anketimit dhe SITP të mundësoj regjistrimin e të dhënave të plota në bazën e të dhënave në SITP. Si dhe të sigurojë që versionin e hartave në SITP dhe në sistemin e anketimit të jetë i njëjtë.
6. **Kontrollet kompensuese**, MFPT të krijoj qasje në SITP për kontrolle kompensuese në komuna, për rishikimin e regjistrimit në SITP.
 - 6.1. **Komunitet** të aplikojnë kontrolle kompensuese përmes rolit të veçantë për rishikim dhe aprovim të regjistrimit të të dhënave në SITP.
7. **Shpërndarja e pagesës në mënyrë proporcionale**, MFPT-ja të sigurojë se SITP bën shpërndarjen e pagesës së borxhit në mënyrë proporcionale edhe në rastet kur pronari në faturë ka më shumë prona. Si dhe të sigurojë pagesën e borxhit dhe borxhin e saktë në zhvillimet e reja.
8. **Regjistrimi i pagesave**, MFPT-ja të sigurojë që SITP merr të dhënat e sakta për pagesat e realizuara siç është koha e saktë e pagesës nga qytetari (iniciativë të pagesës), UNIREF i plotë dhe i saktë me të gjitha të dhënat tjera të pagesës.
 - 8.1. Të krijoj marrëveshje për ndërlidhje me institucionet financiare për të pranuar në kohë reale kohën e saktë të pagesës dhe të bëhet validimi i UNIREF për realizimin e pagesës.
9. **Pasqyra e gjendjes së faturës**, MFPT-ja të sigurojë se SITP bën pasqyrimin e gjendjes reale të faturave dhe pagesave, duke siguruar sinkronizim të saktë midis të dhënave që i shfaqen

qytetarëve në faturë dhe atyre që shihen nga zyrtarët në SITP. Po ashtu, të eliminohen problemet teknike që shkaktojnë parapagime të paqena dhe regjistrime të dyfishta të pagesave.

10. **Zbatimi i kërkesave ligjore**, MFTP-ja të sigurojë se zhvillimet e reja në SITP të mundësojnë pasqyrimin dhe zbatimin e saktë të të gjitha kërkesave ligjore dhe rregullative përmes një kodi të shkallëzueshëm që mundëson zgjerueshmërinë e aplikacionit duke ju përshtatur kërkesave të biznesit.
11. **Gjurmët e auditimit**, MFTP-ja të sigurojë të dhëna të sakta dhe të plota të gjurmëve të auditimit në aplikacion dhe bazë të të dhënave, si dhe duhet të bëjë monitorim të vazhdueshëm dhe sistematik të gjurmëve në bazën e të dhënave, për të siguruar identifikimin dhe parandalimin në kohë të veprimeve të paautorizuara dhe gabimeve.
12. **Llogaritë e përdoruesve**, MFTP-ja të sigurojë aplikimin e procedurës për menaxhimin e përdoruesve, standardizimin e emërimit të llogarive të përdoruesve në formë të unisuar duke shqyrtuar mundësinë e ndërlidhjes apo validimit me domain – Active Directory dhe të mundësoj funksionin në sistem për gjenerimin e fjalëkalimit nga vetë përdoruesit.

Shtojca I. Dizajni i auditimit

Fushat me rrezik dhe treguesit e problemit të auditimit

Tatimit në pronë është gjithëpërfshirës dhe ka rëndësi të veçantë për qytetaret, bizneset si dhe komunat e nivelin qendrorë. Për shkak të rëndësisë që ka ky sistem Zyra Kombëtare e Auditimit ka realizuar edhe në të kaluarën, auditime që ndërlidhen me këtë sistem. Poashtu, vlerësime të të dhënave nga ky sistem ZKA ka realizuar edhe gjatë auditimeve të pasqyrave financiare dhe pajtueshmërisë.

Prandaj, problemet që kemi identifikuar për këtë sistem ndërlidhen me çështjet në vijim:

- Pas pagesës së faturës së tatimit në pronë në sistemin e-Kosova, borxhi në sistemin e tatimit në pronë ende figuron i njëjtë dhe nuk zbritet.
- Zbatim jo i saktë i vendimeve qeveritare në sistem si në rastin e vendimit për pezullimin e interesit dhe gjobave për vitin 2020 i cili nuk është reflektuar saktë në sistem.
- Gabime në përllogaritjen e tatimit për kategori të caktuara të pronave.
- Shpërndarje e pasaktë e parapagimeve.
- Mospërputhje në përllogaritjet e sistemit. Për një tatimpagues janë vërejtur mospërputhje në llogaritje midis pronave në sistemin e tatimit në pronë.
- Zbatim i pasaktë i politikës së faljes së tatimit. Vendimi për faljen e tatimit për vitin 2023 (deri në 100€) nuk është zbatuar për disa tatimpagues.
- Mospërputhje në raportimin financiar, si:
- Mosbarazime mes sistemit të tatimit në pronë dhe sistemit të Thesarit.
- Mosbarazime mes kartelave individuale dhe raporteve të ngarkesës/inkasimit.
- Mospërputhje në zbritjet tatimore (p.sh., aplikimi i zbritjes prej 10,000€ për çdo pronë si banim primar).

Shqyrtimi i treguesve të problemit të identifikuar nga burime të ndryshme, takimet e mbajtura me personat përgjegjës për identifikimin e çështjeve për sistemin e tatimit në pronë, si dhe nga vlerësimet tona të bazuara në Manualin Aktiv të Auditimit të TI-së për identifikimin e fushave më me rrezik nga dokumentacioni i pranuar na orienton në problemin kryesor: sistemi i tatimit në pronë ka mangësi në zhvillimin dhe kontrollin e aplikacionit.

Përshkrimi i sistemit

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT), në bazë të Rregullores për fushat e përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, ka përgjegjësitë për: Përgatitjen, hartimin, miratimin, zbatimin, vlerësimin dhe mbikëqyrjen e politikave publike, hartimin e akteve ligjore, hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, përcaktimin e standardeve të detyrueshme në fushën e menaxhimit të financave publike, kontrollit të brendshëm dhe auditimit për sektorin publik, standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar për sektorin privat dhe ndërmarrjet publike, borxhit publik, prokurimin publik, politikave makroekonomike dhe fiskale dhe ndihmës shtetërore, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Operon dhe mirëmban regjistrat e tatimit në pronë si dhe publikon informacionet lidhur me tatimin në pronë. Kryen vlerësimin e pronës dhe lëshon certifikatat e vlerës së vlerësuar. Kryen vlerësimin tatimor. Përdor masat e mbledhjes së detyrueshme të detyrimeve të papaguara të tatimit në pronë. Kryen kontrole të rregullta dhe inspekte vjetore të komunave lidhur me veprimtarinë, rezultatet dhe zbatueshmërinë e legjislacionit që rregullon procesin e tatimit në pronë, si dhe ndërmerr masat e nevojshme, në rastet e konstatimit të shkeljeve.

MFPT ka 18 departamente, dhe në kuadër të këtyre departamenteve është edhe Departamenti i Tatimit në Pronë. Ku përmes këtij departamentit, udhëheq dhe mbikëqyrë punën për zbatimin e Ligjit dhe akteve nënligjore të nxjerra për zbatimin e tij, në të gjitha komunat e Kosovës. Ky departament përbëhet nga 3 divizione: Divizioni për Inspektim, Divizioni për Çështje Ligjore të Tatimit në Pronë, dhe Divizioni për Informim, Edukim dhe Shërbime Përkrahëse.

Komunat - Çdo Komunë është përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës. Komuna ka përgjegjësitë si në vijim: Regjistron dhe menaxhon të dhënat e tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë, ashtu siç përcaktohet në aktin nën-ligjor që nxjerr Ministria e Financave në pajtim me paragrafin 5. të nenit 14 të Ligjit 06/L-005. Klasifikon pronat e paluajtshme. Inspekton pronat e paluajtshme. Kryen hetim administrativ për të përcaktuar tatimpaguesin sipas këtij Ligji. Bashkëpunon me Ministrinë e Financave për vlerësimin e pronave të paluajtshme. Lëshon faturat e tatimit. Mbledh dhe përdor masat e mbledhjes së detyrueshme të detyrimeve të tatimit në pronë. Shqyrton dhe vendos mbi kërkesat për shtyrjen e pagesës së detyrimeve tatimore. Shqyrton dhe vendos mbi ankesat. Rimbursen tatimpaguesin ose debitorin dhe konstaton shkeljen dhe vendos gjobën përkatëse. Struktura organizative e njësive për administrimin e tatimit në pronë në komuna dhe parimet e administrimit tatimor përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria e Financave në bashkëpunim me komunat. Ndërsa si mostër ekipi auditues ka përzgjedhur komunën e Prishtinës, saktësisht Drejtorinë e Pronës në Komunën e Prishtinës.

Departamenti i Tatimit në Pronë




Figura 3. Departamenti i Tatimit në Pronë dhe divizionet e këtij Departamenti.

Departamenti i Tatimit në Pronë në Ministri, ka për mision zhvillimin dhe hartimin e politikave publike të tatimit në pronë, si dhe sigurimin dhe administrimin e procesit të mbledhjes së tatimit në pronë, përmes bashkëpunimit me strukturat përkatëse. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Departamentit janë: Zhvillon politikat e tatimit në pronë, në bashkëpunim me departamentet përkatëse të Ministrisë. Kryen kontrole të rregullta, ad-hoc dhe inspektime vjetore të komunave, lidhur me veprimtarinë, rezultatet dhe zbatueshmërinë e legjislacionit që rregullon procesin e tatimit në pronë. Përdorë masat e mbledhjes së detyrueshme të detyrimeve të papaguara të tatimit në pronë, në pajtim me legjislacionin në fuqi. Operon dhe mirëmban regjistrat përkatës të tatimit në pronë. Regjistrojnë dhe përditësojnë të dhëna në regjistrat e tatimit në pronë, për të cilat është përgjegjës sipas legjislacionit të tatimit në pronë. Po ashtu asiston dhe mbikëqyr Zyrat e Tatimit në Pronë në komuna, për sa i përket regjistrimit, përditësimit dhe korrigjimit të të dhënave në regjistrat e tatimit në pronë. Kryen vlerësimin tatimor, ofron mbështetje për përgatitjen e faturave të tatimit në pronë dhe autorizon komunat për lëshimin e faturave. Asiston komunat në mbarëvajtjen e tërësishme të procesit të administrimit të tatimit në pronë dhe interpretimin e legjislacionit që rregullon tatimin në pronë. Në bashkëpunim me Departamentin për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative, aprovon qasjen në sistem të zyrtarëve të Zyrave të Tatimit në Pronë në komuna dhe autoriteteve të tjera publike. Bashkëpunon dhe shkëmben informacion me të gjitha autoritetet publike, personat juridikë/fizikë, ose organet që kanë në administrim ose disponojnë informacionin e nevojshëm për administrimin e duhur të tatimit në pronë. Bashkëpunon me Departamentin për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative, për operimin, zhvillimin dhe avancimin e sistemit të tatimit në pronë.

Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë divizionet si në vijim:

- Divizioni për Inspektim;
- Divizioni për Çështje Ligjore të Tatimit në Pronë; dhe
- Divizioni për Informim, Edukim dhe Shërbime Përkrahëse.

Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative



Figura 4. Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative dhe divizionet e këtij Departamenti.

Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative ka për mision të planifikojë, zhvillojë, administrojë, monitorojë, mirëmbajë dhe zbatojë shërbimet efikase dhe efektive të teknologjisë informative për Ministrinë, përmes bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionet e brendshme dhe të jashtme.

Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Departamentit janë: Zhvillon politika, procedura, projekte dhe strategji për funksionimin normal dhe sa më cilësor të TI-së të Ministrisë. Zhvillon dhe zbaton politika dhe procedura teknologjike në përputhje me ato të organizatës, për të siguruar një operim efikas të departamenteve të veçanta. Zbaton politika dhe udhëzime që dalin nga Ministria, në pajtim me kornizën ligjore. Përgatit planin vjetor të punës dhe planifikimin për implementimin e projekteve të reja, mirëmbajtjen e sistemeve ekzistuese dhe planifikimin e harduerit dhe softuerit të nevojshëm për Ministrinë. Bashkëpunon me departamentet në hartimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e politikave, objektivave, planifikimeve afatshkurta dhe afatgjata në fushën e TI-së. Bën zhvillimin, administrimin, monitorimin dhe mirëmbajtjen e përgjithshme të rrjetit, sistemit dhe aplikacioneve të Ministrisë; Zhvillon Planin Strategjik dhe avancimin e sistemeve të teknologjisë informative në Ministrinë dhe agjencitë e saj. Bashkëpunon dhe mban takime të rregullta me njësitë organizative të Ministrisë për adresimin e kërkesave për avancim, zhvillim, administrimin, përmirësim, ndryshim, trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve të rastësishme (ad-hoc), që mund të dalin në lidhje me sistemet e TI-së. Siguron dhe kujdeset për komunikimin zyrtar përmes sistemit elektronik, i cili realizohet përmes postës elektronike. Bashkëpunon dhe koordinohet me agjencitë e Ministrisë në fushën e TI-së dhe bashkëpunon dhe koordinohet me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) dhe institucionet e tjera në fushën e TI-së.

Në kuadër të Departamentit bëjnë pjesë divizionet, si vijon:

- Divizioni për Infrastrukturë dhe Sigurinë e TI-së;
- Divizioni për Operacione të TI-së; dhe
- Divizioni për Menaxhim të Aplikacioneve.

Komuna e Prishtinës - Drejtoria e Pronës

Disa nga detyrat dhe përgjegjësit e Drejtorisë së Pronës janë: Menaxhon me pronën në pronësi komunale; Mban shënime për tokën dhe objektet në pronësi të Komunës; Zhvillon procedurën e shpronësimit të tokës në pronësi private dhe shoqërore për ngastrat e planifikuara për interes publik sipas planeve urbanistike të Komunës; Arrin marrëveshje dhe nënshkruan kontrata me anë të së cilave siguron tokën e nevojshme për realizimin e interesit publik; Nxjerr vendime për regjistrimin e të drejtës së pronësisë në emër të Komunës, në paluejtshmëritë e mbetura pa pronar. Shqyrton dhe vendos për kërkesat e personave fizikë dhe juridikë në procedurë administrative, për rregullimin e marrëdhënieve pronësore – juridikë lidhur me pronën komunale; Zhvillon procedurat administrative, sipas detyrës zyrtare për ruajtjen e pronës komunale dhe interesit tjetër komunal; Harton materialin e nevojshëm për Këshillin e drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa dhe për Kuvendin e Komunës; Bashkëpunon ngushtë me Drejtorinë e linjës, për të dhënat gjeodezike dhe ato pronësore; Bën identifikimin dhe klasifikimin e pronës së paluajtshme; Koordinon punën me drejtorinë kompetente për punët e ndërtimit dhe të kadastrit, në aspektin e lejeve të ndërtimit dhe të dhënave kadastrale; Kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtorisë. Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, Drejtoria e Pronës është e organizuar në këta sektorë:

1. Sektori i Pronës;
2. Sektori për Pronësim, Shpronësim dhe Këmbime.




Figura 5. Shërbimet e ofruara për tatim në pronë nga Komuna e Prishtinës.

Fushëveprimi dhe pyetjet e auditimit

Fushëveprimi i auditimit

Fushëveprimi i këtij auditimi do të jetë MFPT-ja, me fokus të veçantë Departamenti i Tatimit në Pronë, i cili është përgjegjës për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e punëve për zbatimin e ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme dhe akteve nënligjore të nxjerra për zbatimin e tij, në të gjitha komunat e Kosovës, si dhe divizionet e këtij departamenti, të cilat janë: Divizioni për Inspektim, Divizioni për Çështje Ligjore të Tatimit në Pronë dhe Divizioni për Informim, Edukim dhe Shërbime Përkrahëse. Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative dhe Komuna e Prishtinës - Drejtoria e Pronës.

Fokus i auditimit do të jetë blerja dhe zhvillimi dhe kontrollet e aplikacionit për sistemin e teknologjisë së informacionit, sistemi i tatimit në pronë. Auditimi do të mbulojë periudhën nga janari i vitit 2024 deri në përfundim të auditimit.

Pyetjet audituese

Për t'iu përgjigjur objektivit të auditimit ne kemi parashtruar pyetjet si në vijim:

1. A siguron MFPT se projektet sistemi i tatimit në pronë arrin qëllimet e tyre nëpërmjet zhvillimit ?
2. A menaxhon MFPT konfigurimin e produkteve të punës të lidhura me zhvillimin?
3. A ka aplikacioni kontrolle të përshtatshme për vlefshmërinë e hyrjes në mënyrë që të pranon të dhëna të sakta, të besueshme dhe të plota?
4. A sigurojnë kontrollet e aplikacionit integritetin, vlefshmërisë dhe besueshmërisë së të dhënave dhe plotësinë e transaksioneve të tij?
5. A përmban aplikacioni kontrolle që sigurojnë plotësinë dhe saktësinë e rezultateve?
6. A është i sigurt informacioni në sistemin e tatimit në pronë kundrejt keqpërdorimeve?

Kriteret e auditimit²¹

Kriteret e përdorura në këtë auditim rrjedhin nga Manuali Aktiv i Auditimit të TI-së²²; Standardet ndërkombëtare për sigurinë e informacionit²³.

Për të vlerësuar identifikimin e nevojave dhe adresimin e kërkesave për zhvillimin e sistemit të tatimit në pronë janë vendosur kriteret e mëposhtme:

- MFPT duhet të kryej testimet mbi sistemet TI-së dhe duhet të bazohet mbi rezultatet për pranimin ose refuzimin e sistemit.²⁴

²¹ Për më shumë informata konsultoni ISSAI 300, Criteria, p.7

²² Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit është produkt i grupeve të punës së teknologjisë së informacionit të EUROSAT-t (WGITA) si dhe Iniciativës për zhvillim të INTOSAT-t (IDI) për përcaktimin e rregullave e standardeve të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.- më tej Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

²³ Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO/IEC 27000/01.

²⁴ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit –Blerja dhe zhvillimi

- Vetëm ndryshimet e autorizuarra dhe të aprovuara duhet të jenë prezente në mjedisin prodhimit.²⁵

Për të vlerësuar se për sistemin e tatimit në pronë ekzistojnë mekanizma kontrollues të aplikacionit të cilët mundësojnë qasjen e sigurt logjike (nga ana softuerike) dhe të besueshme në sistemin informativ janë vendosur kriteret e mëposhtme:

- Rregullat e vlefshmërisë duhet të jenë të mirë-hartuara, të dokumentuara dhe të zbatuara në ndërveprimin e hyrjeve (inputit); duhet të dokumentohen metoda të ndryshme për futjen e të dhënave; të dhëna jo valide duhet të refuzohen në mënyrën e duhur nga aplikacioni; kriteret e vlefshmërisë përditësohen në mënyrën e duhur dhe të autorizuar; duhet të ekzistojnë kontrolle gjithëpërfshirëse si rregulla regjistrimi dhe autorizimi në rast të mundësisë së kontrolleve thelbësorë të hyrjes; ka kontrolle dhe dokumentim të duhur për hyrjet e aplikacionit.²⁶
- Në aplikacion duhet të ketë të vendosura nivelet e autorizimit të transaksioneve dhe duhet të zbatohen nëpërmjet kontrolleve të ndryshme; të ekzistojë ndarje e saktë e detyrave për futjen e të dhënave; të ekzistojnë kontrolle kompensues për rastet në të cilat ndarja e detyrave nuk është e mundur.²⁷
- Transaksionet e aplikacionit duhet të ekzekutohen në përputhje me sjelljen e pritur²⁸ Transaksionet e aplikacionit duhet të ekzekutohen në mënyrë të kontrolluar dhe të besueshme, duke siguruar që ato të përputhen me rregullat e biznesit, parametrat e konfigurimit dhe skenarët e parashikuar të përpunimit.²⁹
- Organizata duhet të ketë të hartuara procedurat për të siguruar se plotësia dhe saktësia rezultateve të aplikacioneve është vlerësuar përpara përdorimit të rezultatit nga përpunimi i mëtejshëm, përfshirë përpunimin e përdoruesve final; të mundësohet gjurmimi i rezultatit të aplikacionit; rezultati të rishikohet për arsyeshmëri dhe saktësi; kontrollet e plotësisë dhe të saktësisë të jenë efektive.³⁰
- Duhet të ekzistojnë gjurmë të mjaftueshme auditimit që kapin modifikimet, regjistrimet e autorizuarra të transaksioneve kritike; gjurmët e auditimit rishikohen periodikisht për të monitoruar aktivitetet jonormale; gjurmët e auditimit mirëmbahen dhe ruhen në mënyrën e duhur; numra unikë dhe sekuencialë, ose identifikues duhet të jenë të përcaktuar për çdo transaksion.³¹
- Të dhënat e aplikacionit duhet të mbrohen në përputhje me standardet e sigurisë dhe manualin e auditimit të TI-së. Duhet të zbatohen kontrolle efektive të qasjes logjike dhe fizike, siç përcaktohet në domainin mbi Sigurinë e Informacionit, për të siguruar autentifikimin,

²⁵ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit –Blerja dhe zhvillimi

²⁶ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e hyrjes.

²⁷ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e hyrjes.

²⁸ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e përpunimit

²⁹ Përdorimi i udhëzimeve të COBIT (sidomos DSS05 dhe BAI09) për kontrollin e proceseve dhe sigurimin e besueshmërisë së përpunimit të transaksioneve.

³⁰ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e të dhënave dalëse

³¹ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e sigurisë së aplikacionit

autorizimin dhe monitorimin e aksesit. Gjithashtu, aplikacioni duhet të ketë një plan të dokumentuar për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë, duke përfshirë mekanizma të sigurt të backup-it dhe rikuperimit, sipas domainit mbi PVB/PRF. Planet e sigurisë dhe rimëkëmbjes duhet të testohen rregullisht për të garantuar vijueshmërinë e biznesit dhe mbrojtjen e informacionit.³²

Metodologjia e auditimit

Për t'iu përgjigjur pyetjeve audituese dhe me qëllim të mbështetjes së konkluzioneve të auditimit do të zbatojmë metodologjinë në vijim:

Për të vlerësuar identifikimin e nevojave dhe adresimin për zhvillimin e kërkesave të përdoruesve dhe aplikimit të akteve ligjore/nënligjore në sistemin e tatimit në pronë do të realizohen:

- Rishikimi i kërkesave për të përcaktuar nëse ato përfshijnë autorin, datën, prioritetin, koston, rrezikun dhe elemente të tjera. Rishikimi dhe analizimi i kërkesave ose komenteve mbi kërkesat nga pronarët e biznesit – Qeveria, vendimmarrësit ose palët e interesuara për të përcaktuar nëse janë mbledhur dhe përmbledhur të gjitha pikëpamjet për një analizë të përshtatshme (pranimi, shtyrja, refuzimi, etj.). Rishikimi i matricës së gjurmueshmërisë për të përcaktuar nëse kërkesat e miratuara janë caktuar për projekte zhvillimi dhe nëse ndiqen deri në përmbyllje kur implementohen.
- Rishikimin e politikave dhe procedurave për zhvillimin e kërkesave dhe aprovimin, pranimin e punës. Raportet e testimit të zhvillimit të aplikacionit.

Për të vlerësuar se në sistemin e tatimit në pronë ekzistojnë mekanizma kontrollues të aplikacionit të cilët mundësojnë qasjen e sigurt logjike dhe të besueshme në sistemin informativ do të realizohen:

- Analizimi i rregullave, kërkesave, dokumentacionit të aplikacioneve dhe të intervistohen personat përgjegjës të proceseve të biznesit për të përcaktuar se cilat rregulla të vlefshmërisë duhet të sigurohen në procesin e biznesit që po vlerësohet. Rishikimi nëse rregullat e vlefshmërisë janë të mirë hartuara dhe të dokumentuara. Verifikimi nëse kontrollet e vlefshmërisë për të dhënat hyrëse janë në zbatim, ekzekutimi i aplikacionit në mjedis testimi dhe testimi i ndërveprimeve të ndryshme për të dhënat e hyra.
- Inspektimi dhe konfirmimi nëse dizajnimi i sistemit ofron listë të autorizuar për përdorim. Verifikimi nëpërmjet inspektimit të listës së autorizimit, se nivelet e autorizimit janë të mirë përcaktuara për çdo grup transaksionesh. Vlerësimi nëse rregullat e autorizimit për vendosjen e të dhënave, modifikimin, pranimin, refuzimin dhe abuzimin me to, janë të mirë hartuara dhe përcaktuara. Nëse ekziston një tabelë për ndarjen e detyrave, mënyra se si janë të shpërndara detyrat kryesore dhe funksionet e punës, si dhe transaksioneve të lejuara dhe më pas analizojmë listën e përdoruesve dhe listën e privilegjeve të qasjeve të përdoruesve.
- Identifikohen shërbimet e ofruara në platformë dhe grupohen ato sipas rëndësisë të shërbimit që ofron. Rishikimi i dokumentimit të platformës për të verifikuar që është i përshtatshëm, siguron integritet dhe besueshmëri gjatë ciklit të përpunimit të transaksionit.
- Krijohet një listë e verifikimit të të dhënave hyrëse nëse ka ndonjë rishikim paraprak për shërbimet e ofruara. Identifikimi nëse sistemi i tatimit në pronë ka lidhje me sistemet bazë dhe bën validimin e të dhënave nga sistemi burimore. Vlerësimi nëse informacionet dalëse pas

³² Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e sigurisë së aplikacionit

përpunimit në sistemin e tatimit në pronë janë të sakta dhe të plota dhe që gabimet e shfaqura janë të identifikuar.

- Analizimi dhe Rishikimi i politikave dhe procedurave për ruajtjen e gjurmëve të auditimit dhe mënyra e verifikimit të tyre. Verifikimi i gjurmëve të auditimit dhe dokumente të tjera për të verifikuar që gjurma e auditimit është krijuar në mënyrë efektive. Identifikimi se cilët janë personat e autorizuar për shfuqizimin ose fshirjen e gjurmëve të auditimit. Sigurimi që qasja ndaj gjurmëve të auditimit është e kufizuar dhe vetëm personat e autorizuar mund të aksesojnë ato. Vlerësimi nëse gjurmët janë të mbrojtura nga modifikimet dhe nëse ka identifikues unikë për çdo transaksion. Vlerësimi nëse sistemi i tatimit në pronë ka integritetin dhe besueshmërinë e nevojshme.
- Rishikimi dhe analizimi i dokumentacionit të sistemit për të parë nëse informacioni i sistemit është i sigurt kundër keqpërdorimeve. Intervistimi i stafit të TI-së për të parë se si i kuptojnë ata mekanizmat e sigurisë të zbatuara në aplikacion.

Dokumentet relevante

Ligjet

Ligji_Nr._06_L-005__Për_Tatimin_Në_Pronën_E_Paluaajtshme

Rregulloret

Rregullore (Qrk) - Nr. 06/2020 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive

Kjo rregullore përcakton fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të ministrive në Qeverinë e Republikës së Kosovës

Rregullore (Qrk) - Nr. 07/2020 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 06/2020 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive

Rregullore (Qrk) - Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive

Kjo rregullore përcakton fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të ministrive në Qeverinë e Republikës së Kosovës

Rregullore (ZKM) Nr. 02/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Shtojca II: Letër Konfirmimi



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

DATË/A:	22.08.2025
REFERENCË:	/ 2024
PËR/ZA/TO:	z. Samir Zymberi, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Teknologjisë Informative, Zyra Kombëtare e Auditimit
NGA/OD/FROM:	z. Arton Ahmeti, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Letër konfirmimi për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të teknologjisë së informacionit Sistemi i Tatimit në Pronë

I nderuar z. Zymberi,

Përmes kësaj, konfirmojmë se:

- Kemi pranuar draft Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për raportin e auditimit të teknologjisë së informacionit Sistemi i Tatimit në Pronë (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Lidhur me të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna pajtohem, dhe nuk kemi ndonjë koment shtesë për përmbajtjen e Raportit;
- Ju njoftojmë se brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit përfundimtar, do t'ju dorëzojmë një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, i cili do të përfshijë edhe afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Me respekt,

Arton Ahmeti

Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve



KOMUNA E PRISHTINËS/OPSTINA PRISTINA

21-08-2025
NR. BR. 14-470/03-126475/25



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E PRISHTINËS/OPSTINA PRISTINA
MUNICIPALITY OF PRISTINA

LETËR E KONFIRMIMIT			
Niveli Org. Org. Unit	Struktura Class. Code	Nr. Prot. Prot. No.	Nr. Shtete St. Strana
06	44	1447	1

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të teknologjisë së informacionit Sistemi i Tatimit në Pronë, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data:
Prishtinë, 20.08.2025

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit Sistemi i Tatimit në Pronë;
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetar i Kryeqytetit

Përparim Rama





Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës